



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PËR SHTYP

Aktivite në fushën e konkurrencës
(23 - 26 Janar 2017)

Në datat 23-26 Janar 2017, Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (*UNCTAD*), organizoi në Shqipëri disa aktivitete në fushën e konkurrencës.

Këto aktivitete u organizuan në mbështetje të Raportit "*Peer Review*" (2016), që i referohet rekomandimeve përkatëse që *UNCTAD* ka dhënë për Shqipërinë, si dhe në kuadër të projektit që *UNCTAD* ka financuar, për forcimin e kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës, dhe për rritjen e kulturës dhe ndërgjegjësimin të palëve të treta lidhur me ligjin dhe zbatueshmërinë e rregullave të konkurrencës në Shqipëri.

Nëpërmjet këtyre aktivitete u synua forcimi/kualifikimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e ligjit dhe politikës së Konkurrencës, si dhe u përmbyll një cikël trajnimesh të organizuara për stafin e Autoritetit të Konkurrencës si dhe për sistemin gjyqësor në Shqipëri.

Këto aktivitete u fokusuan në tre drejtime:

1. Në datat 23 dhe 25 janar 2017 u zhvilluan seminare trajnuese për stafin e Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshjet e ndaluara, zbulimi i tyre, abuzimi me pozitën dominuese, analizat ekonomike si dhe raste nga praktika. U përcoll eksperiencia e vendeve anëtare të BE-së, nëpërmjet ekspertëve të mundësuar nga *UNCTAD* si dhe u diskutuan raste shqiptare në fushën e konkurrencës.
2. Në datë 24 Janar 2017 është zhvilluar një seminar me temë "Konkurrenca, një mekanizëm për zhvillimin ekonomik", me target kryesor përfaqësuesit e sektorit privat, përfaqësuesit ligjorë të tyre si dhe palë të tjera të interesuara të ftuara në këtë aktivitet.

Prezantimet dhe diskutimet u bazuan mbi kuadrin ligjor evropian dhe atë shqiptar, mbi domosdoshmërinë e respektimit të rregullave të konkurrencës, mbi rëndësinë e konkurrencës si një faktor në promovimin e ekonomisë, etj.

Gjatë diskutimeve u përcoll jo vetëm eksperiencia shqiptare por edhe eksperiencia e vendeve anëtare të BE-së të tilla si Franca, Spanja si dhe ajo e Komisionit Evropian, kuadri ligjor dhe metodologjia që ato përdorin.

Në këtë seminar pati interes dhe u diskutuan çështje të ndryshme që shqetësonin komunitetin e biznesit lidhur me konkurrencën në Shqipëri, por u kërkua edhe mendimi i ekspertëve të huaj lidhur me sqarimin e çështjeve të caktuara në eksperiencën e vendeve të tyre.

3. Në datën 26 janar 2017 është zhvilluar një seminar me temë “Konkurrenca në tregjet dixhitale” me përfaqësues të stafeve akademike, lektorë, studiues si dhe studentë të fushave ekonomike dhe juridike.

Në këtë aktivitet u diskutua lidhur me risitë që sjell dixhitalizimi i shpejte i ekonomisë shqiptare dhe pasojat e këtij dixhitalizimi në fushën e konkurrencës.

Pati diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit lidhur me aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit të konkurrencës në Shqipëri si dhe u përcoll këndvështrimi i ekspertëve të huaj lidhur me këto çështje.